

ADINGPOKS 1BP

Lyerje dy-komponentëshe epokside për mbrojtje të sipërfaqeve të dysHEMEVE nga betoni. I përgjigjet EN 1504-2 (5.1(C), 6.1(C))

Fusha e aplikimit:

Lyerje epokside e ngjyrosur i dedikuar për përpunim përfundimtar të sipërfaqeve të dysHEMEVE të betonuara në depo, garazhe, vende-parkimi, reparte prodhuese në industrinë e ushqimit, spitale, laboratorë, shkolla, qendra tregtare dhe ngjashëm. Mundëson përpunim përfundimtar estetik dhe mirëmbajtje të lehtë në kushte të agresioneve kimike dhe në ngarkesat mekanike. Është i përshtatshëm për punimin e dysHEMEVE monolite, ndërsa me mundësinë për punim në më tepër nuanca lyerja i kënaq kërkesat estetike të pamjes përfundimtare të nënshtresës

Cilësi:

- Adezion i shkëlqyer për nënshtresën
- Rezistent për nga ana mekanike
- Rezistencë ndaj abrazionit
- Rezistent për nga ana kimike në acide të holluara, baza, tretje të kripërave dhe vajra minerare
- Jo-toksik në gjendje të lidhur
- I padepërtueshëm ndaj ujit
- Rezistent ndaj bakteleve
- Realizim i lehtë dhe i thjeshtë me cilindër ose spërkatje
- Dekorativ – mundësi për punim në më shumë nuanca
- I lehtë për mirëmbajtje
- Trashësia e lyerjes 200-250 µm – për një shtresë

Karakteristika teknike:

Cilësi	Metodë	Vlerë e deklaruar
Dukje	-	Përzierje e ngjyrosur pastoze
Raporti i përzierjes	-	A : B = 6,4 : 1
Dendësia e komponentit A	EN ISO 2811-1	(1,65-1,75) g/cm ³
Dendësia e komponentit B	EN ISO 2811-1	(1,00-1,05) g/cm ³
Kohë e përdorimit (pot-life) (20-25°C)	EN ISO 9514	70-90 min
Kohë e hapur për punë	-	30-45 min
Vendosje e shtresës së dytë në temperaturën prej 20-25°C	-	Pas 24 h
Fortësi adezive (lidhje)	EN 1542	≥ 2 Mpa
Rezistencë kimike	-	Pas 14 ditë
Stabilitet i temperaturës	-	prej -20 deri + 70°C

Metodologjia për realizim

(përgatitje e nënshtresës dhe vendosja):

Nënshtresa duhet të jetë e shëndoshë, e pastër, pa yndyrë dhe pa pluhur, me fortësi minimale në presion prej 25MPa. Të gjitha dëmtimet duhet të sanohen me materiale përkatëse. Qumështi i çimentos i dalë mbi sipërfaqe, mbetjet nga suvaja dhe pa pastërtitë e tjera duhet të mënjanoheren me mjete mekanike, përkatësisht kimike. Nënshtresa duhet të prajmerohet me Adingpoks 1P. Në rast të nënshtresave të lagështa, nënshtresa duhet të prajmerohet me Adingpoks 1PV.

Materiali përgatitet me përzjerje të komponentit A me mikser të ngadalshëm elektrik pas së cilës shtohet komponenti B dhe masa përzihet deri në homogjenizimin e plotë në maksimum 500 rrot./min. Përzjerja e ngadalshme e masës është kyçe për t'u shmangur thithja e ajrit dhe paraqitja e defekteve në lyerjen e aplikuar.

Prodhimi mund të vendoset në mënyrë manuale, me cilindër ose me makinë me air-less pompë. Për arritje të shtresës me trashësi të baraspeshuar dhe dukje dekorative përfundimtare, nevojitet që lyerja të vendoset në dy shtresa. Shtresa e dytë vendoset pas fortësimit të shtresës së parë, përkatësisht pas 24 orëve në temperaturë prej 20°C deri 25°C.

Temperatura ambientale dhe temperatura e nënshtresës duhet të jenë në kufij prej 5°C deri 30°C. Në temperatura më të ulëta nevojitet që të kihet kujdes për pikën e krijimit të vesës.

Vërejtje: Nëse materiali vendoset në temperatura në temperatura më të ulëta në kufijtë e të lejuarës, në periudhën përderisa vendoset dhe në periudhën përderisa materiali forcohet, është e nevojshme që të kihet kujdes për pikën e krijimit të vesës. Në kushte të tilla mund të ndodh ndryshimi i ngjyrës së lyerjes në disa pjesë, por ndryshime në cilësitë fizike dhe kimike nuk do të ketë.

Gjatë ndikesës së drejtpërdrejtë të UV-rrezeve, mund të ndodh ndryshimi i ngjyrës dhe humbje e shkëlqimit si dhe të karakteristikave funksionale të materialit.

Rrezik për jetën: Të shmanget kontakti i prodhimit me lëkurën ose sytë, si dhe thithja e drejtpërdrejtë gjatë përzjerjes së komponentëve. Gjatë kontaktit incidental, prodhimi duhet menjëherë të mënjanoheret me leckë të thatë ose e lagur me pak Rastvoruvaç P, e mandej vendi të lahet mirë me ujë të pastër dhe sapun. Nëse materiali spërkat në sy, nevojitet që sytë menjëherë të shpëlahen me ujë të pastër dhe të kërkohet ndihmë mjekësore.

Zjarri: Të sigurohet ajrosje të hapësirave ku punohet me rrëshira dhe tretës.

Pastrimi dhe vendosja në depo: Mbetjet e palidhura të Adingpoks 1B pastrohen me Rastvoruvaç P. Ambalazhi i vjetër i përdorur nevojitet që të deponohet sipas dispozitave dhe regullativave lokale për atë lloj të mbeturinave. Rekomandojmë që mënyra e vendosjes dhe sasitë e nevojshme tu përshtaten kushteve të objektit, si dhe përdorimi i obligueshëm i pajisjes përkatëse.

Shpenzimi:

Vendosje me furçë ose me cilindër me lesh:

Për një shtresë (A + B): 0,30 -0,40 kg/m²

Për dy shtresa (A + B): 0,50 -0,60 kg/m²

Pastrimi:

Veglat dhe pajisja pastrohen me Rastvoruvaç-P, menjëherë pas përdorimit.

Paketimi:

Në set A+B: 5,2 kg

A komponentë: 4,5 kg

B komponentë: 0,7 kg

Në set A+B: 24,3 kg

A komponentë: 21 kg B komponentë: 3,3 kg

Ngjyra standarde:

RAL1001, RAL1002, RAL 1015, RAL1018, RAL1023, RAL1034, RAL3012, RAL3020, RAL5010, RAL5024, RAL6010, RAL6017, RAL6019, RAL6021, RAL6024, RAL7004, RAL7030, RAL7032, RAL7035, RAL7040, RAL7042, RAL7046, RAL7047, RAL9002, RAL9003, Shënim: RAL ngjyrat e tjera mund të prodhohen në sajë të porosive minimale prej 90 kg.

Vendosja ne depo:

Në ambalazh origjinal, të mbyllur, në hapësira të thata, në temperaturë prej 10°C deri 30°C, i mbrojtur nga ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj diellit dhe ngrirjes. Afati i përdorimit: 9 muaj.